



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1438/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit E...SH.P.K, bulevardi "...", fshati ... Komuna e Lipjanit te cilin e përfaqëson me autorizim av. Nebih Troshupa nga Lipjani rr."Lidhja e Prizrenit", ndaj debitorit N.T.P B... te cilin e përfaqëson avokat Arbër Fazliu nga Prishtina rr."Bulevardi i Dëshmorëve te Kombit" D1-II-8-1 ne Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit te ushtruar përmes përfaqësuesit te tij te autorizuar, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.760/21 të datës 28.12.2021, me datën 02.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit E...shpk, me seli në bulevardi ..., fshati ... Komuna e Lipjanit, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.760/21 datës 28.12.2021, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.760/21 të datës 28.12.2021, e ka aprovuar si te bazuar prapësimin e debitorit N.T.P B... te cilin e përfaqëson avokat Arbër Fazliu nga Prishtina rr. "Bulevardi i Dëshmorëve te Kombit" D1-II-8-1 ne Prishtinë, dhe ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.549/2021 të datës 19.04.2021, i lëshuar nga zyra e përmbartuesit privat Driton Govori nga Prishtina si dhe ka refuzuar propozimin për përmbartim te kreditorit "E...." SH.P.K si i pabazuar. Ka detyruar kreditorin E... shpk, ti paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore ne lartësi prej 117.00€ ne afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit te këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori përmes përfaqësuesit te tij te autorizuar av. Nebih Troshupa, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles së dytë ta aprovoj këtë ankesë, te prish

aktvendimin e gjykatës se shkalles së parë ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet ne fuqi ashtu qe ta detyroj debitorin ti paguaj shpenzimet e procedurës.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 19.04.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-Kartelës financiare. Përmbartuesi privat Driton Govori nga Prishtina, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.549/2021 te datës 19.04.2021, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit t'i paguaj shumën prej 213.00€.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 26.04.2021, duke pretenduar se nuk qëndrojnë pretendimet e kreditorit se debitori i ka borxh, është papranueshme se si organi përmbartues i është referuar te gjitha faturave të kreditorit pa e specifikuar saktë se cila prej faturave janë paguar dhe cila faturë përmban obligimin kryesor. Përmbartuesi privat ka tejkualuar kompetencat e veta, pasi propozimi për përmbartim është bërë ne bazë te dokumentit jo përmbartues dhe jo te saktë, në kundërshtim me procedurën përmbartimore pasi asnjëri nuk është dokument përmbartues, sepse faturat nuk janë të nënshkruara dhe të pranuar nga debitori apo personat e autorizuar, propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, ta anuloj urdhrin përmbartimor dhe te gjitha veprimet e ndërmarra deri më tash ndërsa ta obligoj kreditorin E...SH.P.K, ti paguaj shpenzimet e procedurës.

Përgjigje ne prapësim ka paraqitur kreditori me datën 28.04.2021, me arsyetimin se kartela e bashkangjitur në fatura është dokument i besueshëm, sa i përket pretendimeve te debitorit për vlerën e borxhit, ky pretendim nuk qëndron ndërsa thekson se shuma e borxhit në kartelën financiare është e papaguar, shton se të gjitha faturat i kemi dërguar palës me email adresë tek kompania NTP B... dhe asnjëherë nuk na është kthyer prapa nga debitori, andaj propozon që gjykata te marrë vendim që të mbetet në fuqi urdhri për përmbartim dhe debitori te detyrohet ti paguaj shpenzimet e procedurës.

Gjykata Themelore në Prishtinë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë Aktvendimin PPP.nr.760/21 te datës 28.12.2021, me të cilin e ka aprovuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka arsyetuar se propozimi për përmbartim është bërë ne bazë te titullit përmbartues ku është përmendur Kartela Financiare pa numër dhe datë por që në shkresat e lëndës janë prezantuar fatura nr..... e datës 29.02.2020 dhe specifikacioni i furnizimeve

(derivate), por fatura dhe specifikacioni nuk janë dorëzuar ne original apo kopje të vërtetuar ashtu siç parasheh neni 37 i LPP. Po ashtu gjykata e shkallës së parë i referohet edhe nenit 38 par.1 te LPP, ashtu qe mbi këtë bazë vlerëson se përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin pa vlerësuar paraprakisht se propozimi për përmbarim a i plotëson kushtet ligjore te parapara ne dispozitën ligjore si më lartë, ka lejuar përmbarimin në bazë te faturës apo specifikacionit jo origjinal apo kopje e vërtetuar por janë dorëzuar ne kopje dhe si te tilla nuk plotësojnë kushtet për te qenë titull i përshtatshëm për përmbarim, andaj vlerëson se nuk ka pasur kushte ligjore për inicim te procedurës se përmbarimit konform nenit 29 par.3 dhe nenit 37, ashtu që përmbarimi është lejuar ne kundërshtim me nenin 21, 29, 37, 43 par.4 te LPP-së, ashtu që vendosi si ne dispozitiv.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale–Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër Urdhrit të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori. Shiquar ne shkresat e lëndës edhe kjo gjykatë konstaton se propozimi për përmbarim është iniciuar ne bazë te dokumentit "kartelë financiare" pa numër dhe datë te lëshimit, e që ne fakt këtij propozimi i janë bashkangjitur Fatura nr..... e datës 29.02.2020 si dhe specifikacioni i furnizimeve me numër dhe datë te njëjtë si në faturë, mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi por të njëjtat janë jo origjinale të lëshuara nga kreditori, e të cilat dokumente nuk janë në pajtim të nenit 29 të LPP-së, nuk e kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe si të tilla nuk paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ashtu siç përcaktohet edhe me dispozitën e nenit 21 të njëjtit ligj, i cili thotë se: *"Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm ne bazë te dokumentit përmbarues dhe dokumentit te besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër"*. Po ashtu propozimi për përmbarim i ushtruar nga kreditori del të mos jetë ne pajtim me nenin 37 të LPP-së i cili thotë se *"kur propozimi për përmbarim paraqitet ne bazë te dokumentit te besueshëm, mjafton qe propozimit ti bashkëngjitet dokumenti i tillë ne origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit"* e qe ne fakt ne rastin konkret fatura nr.001-021-000285/20 e datës 29.02.202, ne bazë te cilës është propozuar përmbarimi si dhe specifikacioni i furnizimeve janë kopje dhe jo origjinale siç kërkojnë dispozitat ligjore.

Prandaj Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë, rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Më te drejt gjykata e shkalles se parë ka vlerësuar se kreditori ne rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht te vlefshme në mbështetje të pretendimeve te tij.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i

kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1438/22, me datë 02.11.2022

Gjyqtari,
Krenar Berisha